



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:017547

Datë: 19.06.2024

Numri i dokumentit: 05835354

KPPP.nr. 96/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Dauti Transport Shped AD, me numër 5747546 dhe me seli në Saraj, kundër debitorit “Komerling Fermeture” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810042086 dhe seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rashiti, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 757/23 e datës 14.12.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Sheremet Livoreka nga Kaçaniku, jashtë seancës me datën 19.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Komerling Fermeture” Sh.P.K., ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr. 757/23 i datës 14.12.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Sheremet Livoreka, në shumën prej 50.00 EUR.
- II. REFUZOHET pjesa tjetër e prapësimin të debitorit “Komerling Fermeture” Sh.P.K. ashtu që MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor P.nr. 757/23 i datës 14.12.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Sheremet Livoreka, për pjesën e detyrimit në vlerë prej 4,950.00 EUR.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit Dauti Transport Shped AD, ka nxjerr urdhrin P.nr. 757/23 me datë 14.12.2023 me të cilin ka caktuar zbatimin e përbarimit ndaj debitorit “Komerling Fermeture” Sh.P.K., në bazë të titullit ekzekutiv - Kontratë për pagesën e borxhit të mbetur me nr. LRP.nr. 9081/2023 dhe nr. ref. 2152/2023 e

datës 12.09.2023, duke e detyruar debitorin që të i'a paguaj kreditorit shumën e borxhit të papaguar nga kontrata e lartcekur në vlerë prej 5,000.00 EUR, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor, me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është iniciuar procedura përmbartimore nuk përbën dokument përmbartimor as të besueshëm sipas nenit 36 të LPP-së. Ka shtuar se detyrimi sipas kontratës noteriale LRP.nr. 9081/2023, është në tërësi e përmbushur në shumën prej 17,450.00 €, duke ofruar si dëshmi edhe pagesat e realizuara përmes transferove bankare të datës 30.01.2023, 29.11.2023 dhe 02.12.2023. Fakti se janë realizuar pagesat nga debitori me destinim dhe për qëllimin për të cilin janë kryer punët, pas pagesës së detyrimit kontrata nuk ka asnjë efekt dhe nuk mund të kërkohet që në bazë të saj të lejohet përmbartimi. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e prapësimit në vlerë prej 156.00 EUR.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se për Marrëveshjen për pagesën e borxhit të mbetur, e cila është përpiluar pranë zyrës noteriale është njoftuar edhe debitori se e njëjta ka titull ekzekutiv sipas nenit 22 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se pretendimet e debitorit së ka përmbushur detyrimin janë të pa bazuara për faktin se debitori sipas marrëveshjes ka paguar pjesërisht borxhin dhe atë në shumë prej 12,450.00 €, ndërsa ka mbetur edhe shuma prej 5,000.00 €. I ka propozuar gjykatës që të hudhë poshtë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaket si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së, përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.3, përcaktohen dokumentet përmbartuese siç janë: *“dokumenti noterial i përmbartueshëm në pajtim me ligjin për noterinë;”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së,

përcaktohet se *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Sipas nenit 43 të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë përcaktohet se *“Dokumenti noterial është dokument përbarimor në qoftë se është përpiluar në formën e paraparë dhe nëse në të është përcaktuar kryerja e detyrimit të caktuar për të cilën palët mund të merren vesh dhe nëse përmban deklaratën e detyruesit për atë që në bazë të atij dokumenti, mundet, e me qëllim të realizimit të detyrimit, pas arritshmërisë së detyrimit, në mënyrë të drejtpërdrejt të zbatohet përbarimi i detyrueshëm*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se dokumenti noterial - Marrëveshja për pagesën e borxhit të mbetur me nr. LRP.nr. 9081/2023 dhe nr. ref. 2152/2023 e datës 12.09.2023 në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përbarimor dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara me nenin 27 par.1 të LPP-së, pasi që përmban kreditori, debitorin, mjetet, objektin e detyrimit si dhe kohën e përmbushjes së këtij detyrimi. Po ashtu, dokumenti në fjalë i plotëson edhe kushtet e veçanta të përcaktuara me nenin 43 të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë, meqenëse i njëjti përmban dispozitat e vlefshme mandatore të pajtuara nga palët për efektin përbarues të këtij vendimi.

Duke shqyrtuar pretendimet e debitorit për përmbushje të borxhit, gjykata gjeti se nga Marrëveshja për pagesën e borxhit të mbetur me nr. LRP.nr. 9081/2023 dhe nr. ref. 2152/2023 e datës 12.09.2023, debitori është dakorduar me kreditorin që në emër të borxhit të arritur për pagesë sipas faturave nr. 791-31 /52, faturës nr. 4751-31/7, faturës nr. 889-31/97, faturës nr. 97-31-12, faturës nr. 889-31-103, faturës nr. 7479-31/19 dhe faturës nr. 108-31/26 në shumën totale prej 17,450.00 EUR, debitori do ta paguaj borxhin me këste dhe atë shumën prej 7,450.00 EUR deri me datë 30.09.2023, shumën prej 5,000.00 EUR deri me datë 15.10.2023 shumën prej 5,000.00 EUR deri me datë 30.10.2023.

Në këtë drejtim, debitori, me provat e paraqitura në prapësim ka vërtetuar faktin që lidhur me faturat e lartcekura, i njëjti ka bërë pagesë me datë 30.10.2023 në vlerë prej 2,450.00 EUR dhe pagesë me datë 30.10.2023 në vlerë prej 10,050.00 EUR, apo në total shumën prej 12,500.00 EUR, ku në përshkrimet e këtyre pagesave, evidentohen faturat në emër të të cilave është nënshkruar edhe kontrata e borxhit.

Andaj, meqenëse borxhi për të cilin debitori është detyruar për pagesë sipas aktit noterial ka qenë në vlerë prej 17,450.00 EUR, ndërsa debitori ka dëshmuar me prova në prapësim se ka paguar shumën prej 12,500,00. EUR, rezulton se shuma e mbetur për pagesë sipas kësaj kontrate është në vlerën prej 4,950.00 EUR dhe jo 5,000.00 EUR siç është kërkuar me propozimin për përmbarim.

Nga këto të gjetura, në mbështetje të nenit 71, par.1, nën-par 1.1 të LPP-së me të cilin parashihet se prapësimi është i bazuar kur *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* gjykata vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke anuluar urdhrin për lejimin e përmbarimit për vlerën prej 50.00 EUR nga totali prej 5,000.00 EUR i kërkuar me propozimin për përmbarim, dhe duke lënë në fuqi urdhrin për lejimin e përmbarimit në vlerë prej 4,950.00 EUR.

Gjykata morri për bazë edhe pagesën e bërë nga debitori me datë 02.11.2023 në vlerë prej 2,600.00 EUR, si dhe pagesën e datës 29.11.2023 në vlerë prej 1,000.00 EUR, por që pagesat në fjalë, i referohen faturës nr. 136/31-23 të datës 25.10.2023, respektivisht faturave nr. 157-31/31 dhe 157-31/32, fatura këto të cilat nuk janë objekt i marrëveshjes për pagesën e borxhit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi në këtë procedurë, andaj të njëjtat nuk paraqesin dëshmi për pagesën e borxhit të mbetur nga debitori për kreditorin.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 96/24, datë 19.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.